



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1767/24 Datë: 28/08/2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së dytë (2) të jashtëzakonshme për vitin 2024, mbajtur më datë 23.08.2024 Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

**V E N D I M**

- I.** Akreditohen programet e studimit të Kolegjit AAB kampusi kryesor për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2024 - 30 shtator 2027):
  - *Programim i Lojërave Kompjuterike BA Prof. 180 ECTS (A) me kuotën maksimumi 100 studentë për vit akademik;*
  - *Biznes Digjital, BA Prof. 180 ECTS (A) me specializimet: 1. Inteligjenca Artificiale në Biznes, 2. Menaxhimi i Rrjeteve Sociale, me kuotën maksimumi 120 studentë për vit akademik;*
- II.** Riakreditohen programet e studimeve të Kolegjit AAB kampusi kryesor për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2024 - 30 shtator 2027):
  - *Administratë Publike BA 180 ECTS (R) me specializimet: 1. Administratë Publike; 2. Shkenca Politike dhe Diplomaci, me kuotën maksimumi 200 studentë për vit akademik;*
- III.** Numri i studentëve zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- IV.** Obligohet Kolegji AAB kampusi kryesor që deri më datë 15.11.2024 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- V.** Obligohet Kolegji AAB kampusi kryesor të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet vetëm me vendim nga KShC.
- VI.** Institucioni i Arsimit të Lartë si në paragrafin I mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VII.** Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## ARSYETIM

Kolegji AAB kampusi kryesor brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për akreditim dhe riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	Programim i Lojërave Kompjuterike BA Prof. 180 ECTS (A)	Ardian Isufi Elissa Mollakuqe Leutrina Bajrami
2.	Biznes Digjital (me 2 specializime), BA Prof. 180 ECTS (A), me specializimet: 1. Inteligjenca Artificiale në Biznes, 2. Menaxhimi i Rrjeteve Sociale	Engin Melekoglu Rezarta Gashi Fjolla Trakaniqi Fellenze Pula
3.	Administratë Publike (me 2 specializime) BA 180 ECTS (R), me specializimet: 1. Administratë Publike; 2. Shkenca Politike dhe Diplomaci	Vrullim Buja Donik Sallova Bashkim Rrahmani Xhemazie Ibrahimimi Jeton Kelmendi

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin AAB kampusi kryesor me ekipet në përbërje: Peter Normak, Rainer Harms, Christoph Back, Peter Parycek, Matthew Kitching dhe Juraj Bogat.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit; Programim i Lojërave Kompjuterike BA Prof. 180 ECTS**, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 18.07.2024, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë: Plotësisht dy (2) dhe Substancialisht kater (4) dhe Pjesërisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit.
- Për programin e studimit; Biznes Digjital (me 2 specializime), BA Prof. 180 ECTS**, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 18.07.2024, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë: Plotësisht dy (2) dhe Substancialisht pesë (5) fusha të standardeve të akreditimit.
- Për programin e studimit; Administratë Publike (me 2 specializime)BA 180 ECTS**, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 18.07.2024 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë: Plotësisht pesë (5) dhe Pjesërisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e dytë (2) të jashtëzakonshme për vitin 2024, mbajtur më datë 23.08.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin e Kolegjit AAB kampusi kryesor dhe duke u bazuar në raportet

e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegji AAB kampusi kryesor;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,

  
  
Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi  
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë